

	REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVA KOMUNA E RAHOVECIT OPSTINA ORAHOVAC MUNICIPALITY OF RAHOVEC	
---	--	---

Për:	Grup i Operatorëve Ekonomik: DACHGroup SH.P.K.; HARST Group SH.P.K., Lakrishte, rr. Tirana, H.C, kati 5 S1, 10000, Prishtinë Të gjitha palëve të interesuar
Nga:	Astrit Mullabazi, Menaxher i Zyrës së Prokurimit
Lënda:	VENDIM për Rishqyrtim të Kërkesës
Datë:	31.08.2023

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Rahovecit, në mbështetje të nenit 108/A, paragrafi 10.1 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 63 paragrafi 1 të Rregullores **Nr. 001/2022** për Prokurim Publik, sa i përket **Kërkesës për Rishqyrtim** të datës: **30.08.2023**, të parashtruar nga **Grup i Operatorëve Ekonomik: DACHGroup SH.P.K.; HARST Group SH.P.K.** me adresë në **Prishtinë**, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **NDËRTIMI DHE RENOVIMI I QMF–ve DHE AMF–ve – Ritenderim**, me Numër të prokurimit: **623-23-6893-5-2-1**, Numër i brendshëm: **623-23-030-5-2-1**, nxjerr:

VENDIM

- I. HEDHET POSHTË** si e pa bazuar Kërkesa për rishqyrtim e parashtruar nga **Grup i Operatorëve Ekonomik: DACHGroup SH.P.K.; HARST Group SH.P.K.** me adresë në **Prishtinë**, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **NDËRTIMI DHE RENOVIMI I QMF–ve DHE AMF–ve – Ritenderim**, me Numër të prokurimit: **623-23-6893-5-2-1**, Numër i brendshëm: **623-23-030-5-2-1**, kundër Njoftimit mbi vendimin e AK–së, të datës: **25.08.2023**, të publikuar në ueb – faqe: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.
- II.** Autoriteti Kontraktues, vendos që të vazhdoj me me hapat e mëtejshëm për këtë aktivitetin të prokurimit
- III.** Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronik në adresën: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

ARSYETIM

Grup i Operatorëve Ekonomik: DACHGroup SH.P.K.; HARST Group SH.P.K. me adresë në **Prishtinë**, me datë: **30.08.2023** si palë e pakënaqur ka deponuar Kërkesë për Rishqyrtim pran AK Komuna e Rahovecit, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **NDËRTIMI DHE RENOVIMI I QMF–ve DHE AMF–ve – Ritenderim**, me Numër të prokurimit: **623-23-6893-5-2-1**, Numër i brendshëm: **623-23-030-5-2-1**, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/ - Komuna e Rahovecit, kundër Njoftimit mbi Vendim të AK-së të publikuar me **25.08.2023** në linkun <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

BAZA LIGJORE PËR REFUZIM TË KËRKESËS

Përgjigjja e AK ndaj Pretendimeve Ankimore;

Ju sqarojmë se pretendimet e tua ankimor nuk qëndrojnë dhe janë të pabazuar, pasi që vlerësimi i ofertave është bërë konform Ligjit Nr. 04/042, Ligji për Prokurimin Publik Autoriteti Kontraktues: Komuna e Rahovecit, ju ka Njoftuar juve si Operator Ekonomik ankues, sipas formularit **B42 Letër Standarde për tenderuesin e eliminuar**, ku nuk e keni plotësuar këto kriter sipas Njoftimit për Kontrate/Dosjes se tenderit:

Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

Kërkesa 2: Operatori Ekonomik duhet të ketë Kapital te mjaftueshëm për realizimin e kontratës, mjete te gatshme në bankë ose akses në kredi nga banka në vlerë prej së paku: 70,000.00 €;

Dëshmia 2: Dokumenti të jetë origjinal i nënshkruar dhe vulosur nga institucioni bankar lidhur me këtë projekt;

Sqarimet janë si në vijim:

Në ofertën e juaj të dorëzuar, dokumentin e prezantuar nga Banka Kombëtare Tregtare Sh. A. ne baze të Kërkesë Nr. 2 të Kapacitetit Ekonomik dhe Financiar, është i pa pranueshëm për ne si AK: Komuna e Rahovecit, pasi ne Letër Mbështetje nga Banka, ceket: *Ne ketë kuadër ne rast se Shoqëria e fiton te drejtën e zhvillimit te projektit ne fjalë, Banka Kombëtare Tregtare Sh. A do ta shqyrtoj mundësin e trajtimit te kërkesës se ndërmarrjes “HARST Group SHPK”, për financimin e këtij projekti deri në shumë prej: 70,000 Euro, gjithmonë konform kriterëve te kreditimit te vendosura nga Banka Qendrore, procedurave dhe rregulloreve te brendshme te Bankes Kombëtare Tregtare Sh. A. si dhe procedurave te Bankes Kombëtare Tregtare;*

Letër mbështetja e lëshuar nga banka për ju si Operator ekonomik nuk ofron as minimumin e sigurisë për Autoritetin Kontraktues që ju si Operator Ekonomik do të keni mbështetje në mjete e kërkuara, e njëjta vërteton se ju jeni klient i kësaj banke dhe banka potencon se **mund** ta mbështesin nëse ju si klient plotësoni kushtet dhe kriteret e brendshme te bankës, duke u bazuar në vlerësimin e kapacitetit financiar të klientit, **andaj oferta juaj konsiderohet e papërgjegjshme konform nenit 59.4 të LPP-së**

Kapaciteti teknik dhe profesional:

Kërkesa 2: Operatori Ekonomik duhet te ketë ne listën te paktën këtë staf profesional:

2.6. Një (1) punëtor të certifikuar si Moler, duhet të jenë të pajisur me diplomë përkatëse nga një Qendër e Aftësimit Profesional;

2.7. Një (1) punëtor të certifikuar si Suvatues, duhet të jenë të pajisur me diplomë përkatëse nga një Qendër e Aftësimit Profesional;

2.8. Një (1) punëtor të certifikuar si Murator, duhet të jenë të pajisur me diplomë përkatëse nga një Qendër e Aftësimit Profesional;

2.9. Një (1) punëtor Hidroinstalues, duhet të jenë të pajisur me diplomë përkatëse nga një Qendër e Aftësimit Profesional;

2.10. Një (1) punëtor të certifikuar si Instalues i ngrohjes qëndore, duhet të jenë të pajisur me diplomë përkatëse nga një Qendër e Aftësimit Profesional;

Dëshmia 2: Për kërkesat (2.6; 2.7; 2.8; 2.9; 2.10;)

• *Diploma apo Certifikata përkatëse – Kopje të noterizuar;*

Sqarimet janë si në vijim:

Në ofertën e juaj të dorëzuar si Operatorë Ekonomik, keni dorëzuar punëtor te certifikuar nga trupa certifikuese, përkatësisht nga Organizata e trajnimit “AQSCERT “Organizëm i Vlerësimit të Konformitetit” dhe jo sipas kërkesës se AK-se ku është kërkuar nga Qendra te Aftësimit Professional, për me tepër trajnimi për punëtor është bere online sipas certifikatës se lëshuar nga AQS CERT ku dëshmon qe këta punëtor nuk e kanë përvojën praktike te duhur te cilën edhe e ka kërkuar AK- sepse Qendrat e Aftësimit Profesional kryejnë trajnimin praktik dhe teorik, andaj oferta juaj konsiderohet e papërgjegjshme konform nenit 59.4 të LPP-së

Kërkesa 5: Operatori Ekonomik duhet te posedoje mjetet, stabilimentet dhe pajisjet teknike që janë te domosdoshme për realizimin e projektit, pajisjet dhe mekanizimi i obligueshëm sipas tabelës ne Aneksin 8 te Dosjes se Tenderit;

Dëshmia 5: Pajisjet të cilat regjistrohen duhet të dëshmohen me librezën e regjistrimit (pajisjet duhet te jene me afat te regjistrimit), ndërsa pajisje tjera Operatori Ekonomik duhet ti dëshmoj me një dokument për pronësinë e pajisjeve (faturë apo DUD etj.).

Vëmendje!

Ne rast se OE nuk posedon pajisjet mbi pronësinë duhet te ofroj marrëveshjen për marrjen me qira te pajisjeve. Marrëveshja duhet te jete ne emër te këtij projekti me validitet të kohëzgjatjes të kësaj kontrate e nënshkruar dhe vulosur nga te dyja palët. Marrëveshja duhet te jete e noterizuar ne mes te qiradhënësit dhe qiramarrësit.

Sqarimet janë si në vijim:

Në ofertën e juaj të dorëzuar si Operatorë Ekonomik, keni prezantuar Pajisjet sipas Aneksit 8. PAJISJET DHE MEKANIZIMI I OBLIGUESHËM, por disa pajisje kanë qenë në emër të Kompanisë VB Tofaj, mungon Marrëveshja për makinerinë me këtë kompani, ku në dëshminë e kërkuar dokumentare është cekur: *Ne rast se OE nuk posedon pajisjet mbi pronësinë duhet te ofroj marrëveshjen për marrjen me qira te pajisjeve. Marrëveshja duhet te jete ne emër te këtij projekti me validitet të kohëzgjatjes të kësaj kontrate e nënshkruar dhe vulosur nga te dyja palët. Marrëveshja duhet te jete e noterizuar ne mes te qiradhënësit dhe qiramarrësit.* Andaj oferta juaj konsiderohet e papërgjegjshme konform nenit 59.4 të LPP-së

Nga konstatimet e lartcekur u vendos si në dispozitave të këtij Vendimi.

Kjo procedurë është trajtuar konform Ligjit Nr. 04/042, Ligji për Prokurimin Publik ne Republikën e Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-92.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij **vendimi të AK-së ju munde të paraqitni** ankesë pranë OSHP-së në pajtim me nenin 109 të LPP-së. Ankesa pranë OSHP-së duhet të dorëzohet brenda 10 (dhjetë) ditëve pas vendimit të lëshuar nga Autoriteti Kontraktues.

Vendimi Publikohet:

Në platformën elektronike në adresën: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>

Astrit Mullabazi
Menaxher i Zyrës se Prokurimit
Komuna e Rahovecit